Vendim nr. 256, datë 20.07.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 20.07.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 33 (A) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **AGIM ISMAILI,** përfaqësuar nga avokati Kastriot Selita, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 65, datë 06.03.2026 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Pezullimi i zbatimit të vendimit nr. 65, datë 06.03.2026 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të subjektit të interesuar.

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 11, 17, 41, pika 5, 42, pika 2, 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 71, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) ka regjistruar procedimin penal nr. 277 të vitit 2020 (*procedimi penal nr. 277/2020*) për veprat penale, konkretisht "Shpërdorimi i detyrës", të kryer në bashkëpunim, "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë", "Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë", të kryer në bashkëpunim, "Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale", të kryer në bashkëpunim, të parashikuara respektivisht nga nenet 248 e 25, 260, 245 dhe 25, 287 të Kodit Penal (*KP*). Në kuadër të këtij procedimi penal janë kryer një sërë veprimesh hetimore, të tilla, si: këqyrje, sekuestrime, pyetje personash etj.

2. Me vendimin e datës 19.09.2022 prokurori i çështjes ka vendosur ndarjen e këtij procedimi penal, ndër të tjera, edhe në procedimin penal nr. 277/1 të vitit 2022, për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", të parashikuar nga neni 248 i KP-së. Ndërkohë, me vendimin nr. 21, datë 21.02.2023, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) ka pranuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për dërgimin në gjyq të çështjes penale që i përkiste procedimit penal nr. 277/2020.

3. Në datën 12.03.2025 Prokuroria e Posaçme është vënë në dijeni se shtetasi Z.Gj., nëpërmjet *WhatsApp-it*, i kishte dërguar administratorit të një portali mediatik dokumente që përkonin me materialet e administruara në procedimin penal nr. 277/1 të vitit 2022. Nga veprimet hetimore është identifikuar edhe shtetasi A.Rr., nga i cili Z.Gj. kishte marrë mesazhet dhe materialet në fjalë. Për këtë shkak, në datat 12 dhe 13 mars 2025 emrat e tyre janë shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, si persona që u atribuohej kryerja e veprave penale "Ndërhyrje në sistemet kompjuterike", "Zbulimi i akteve ose i të dhënave sekrete", të kryera në formën e posaçme të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, "Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", të parashikuara nga nenet 293/c, paragrafi 2, 295/a paragrafi 4, 28/4, 333/a dhe 334 të KP-së.

4. Me vendimin e prokurorit të datës 02.07.2025, nga procedimi penal nr. 277/1 i vitit 2022 janë veçuar aktet që lidheshin me veprat e mësipërme dhe është regjistruar procedimi penal nr. 277/1/1 i vitit 2025. Në vijim, me vendimin e prokurorit të datës 03.10.2025, në regjistër është bërë pasqyrimi i ndryshimit të cilësimit juridik të veprave penale ndaj A.Rr. dhe Z.Gj., konkretisht "Hyrja e paautorizuar kompjuterike", "Përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterike", të kryer në formën e posaçme të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar

kriminal, “Grupi i strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 192/b, paragrafi 2, 293/a, paragrafi 2, 28/4, 333/a dhe 334 të KP-së. Po në këtë datë, në regjistër është shënuar edhe emri i kërkuesit, ish-drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, si person i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterike”, të kryer në formën e posaçme të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, “Grupi i strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuara nga nenet 293/a, paragrafi 2, 28/4, 333/a dhe 334 të KP-së.

5. Sipas Prokurorisë së Posaçme, nga komunikimet ndërmjet Z.Gj., A.Rr. dhe kërkuesit, deklarimet e tyre dhe provat e tjera të administruara gjatë hetimit paraprak, rezultonte se A.Rr. kishte aksesuar në mënyrë të paautorizuar *e-mail*-et e prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme dhe materialet e marra prej tyre i kishte transmetuar te Z.Gj., i cili, nga ana e tij, i kishte përcjellë edhe te kërkuesi. Ky i fundit rezultonte se disa prej këtyre materialeve ua kishte transmetuar personave të tretë dhe kishte kërkuar vijimin e kërkimit të materialeve edhe për persona të tjerë. Kjo e fundit, sipas Prokurorisë së Posaçme, lidhej edhe me shkarkimin e kërkuesit nga detyra e drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe me komunikimet e tij për kërkimin dhe gjetjen e materialeve “mundësisht inkriminuese” ndaj ministrit të Drejtësisë në detyrë në atë kohë, çka, sipas saj, përbënte edhe motivin dhe/ose arsyet personale të kërkuesit.

6. Në datën 13.01.2026 Prokuroria e Posaçme ka paraqitur kërkesën për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. 277/1/1 të vitit 2025, ndër të tjerë, edhe ndaj kërkuesit, për akuzat e kryerjes së veprave penale të parashikuara nga nenet 293/a, paragrafi 2, 28/4, 333/a dhe 334 të KP-së. Me vendimin nr. 65, datë 06.03.2026 të GJKKO-së së Shkallës së Parë gjyqtari i seancës paraprake ka pranuar kërkesën dhe e ka dërguar çështjen për gjykim. Sipas saj, provat e administruara gjatë hetimit ishin të mjaftueshme për të mbështetur akuzat dhe, në këtë fazë të procedimit, gjyqtari i seancës paraprake duhej të verifikonte nëse ekzistonin prova të mjaftueshme në drejtim të vërtetimit të akuzës, pa kryer vlerësimin e tyre përfundimtar, i cili i përkiste gjykimit të themelit. Po kështu, gjykata ka theksuar se procedura e seancës paraprake nuk zëvendësonte gjykimin e çështjes në themel dhe as paragjykonte vendimin përfundimtar.

7. Për sa i përket akuzës së ngritur ndaj kërkuesit, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se shkëmbimi dhe transmetimi i dokumenteve të aksesuara nga *e-mail*-et e prokurorëve të posaçëm nuk ishte rastësor, por lidhej me marrëdhëniet e mëparshme profesionale dhe shoqërore ndërmjet të pandehurve. Sipas saj, nga përmbajtja e komunikimeve të administruara rezultonte se dokumentet e marra nga sistemi i Prokurorisë së Posaçme i ishin transmetuar kërkuesit, i cili më pas i kishte transmetuar edhe te persona të tretë dhe kishte kërkuar vazhdimin e kërkimit dhe marrjen e dokumenteve edhe për persona të tjerë. Në këto

rrethana, gjykata ka çmuar se kishte prova të mjaftueshme për të mbështetur akuzën se kërkuesi, së bashku me dy të pandehurit e tjerë, kishin vepruar në formën e posaçme të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal.

8. GJKKO-ja e Shkallës së Parë i ka gjetur të pabazuara pretendimet e mbrojtjes për pushimin e çështjes ose ndryshimin e kualifikimit juridik të veprave penale, duke vlerësuar se çështjet që lidhen me fuqinë provuese të provave dhe provueshmërinë përfundimtare të akuzës i përkasin gjykimit të themelit. Po kështu, ajo e ka gjetur të pabazuar edhe pretendimin për mungesën e kompetencës lëndore, pasi, referuar nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), ndër akuzat për të cilat kërkohej dërgimi i çështjes në gjyq, përfshiheshin edhe vepra penale të kryera në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, për gjykimin e të cilave GJKKO-ja është kompetente. Gjithashtu, gjykata e ka gjetur të pabazuar edhe pretendimin se Prokuroria e Posaçme, duke qenë viktimë e veprës penale, ndodhej në konflikt interesi dhe për këtë shkak duhej të shpallte moskompetencën për zhvillimin e hetimeve, duke ia deleguar atë një prokurorie tjetër kompetente. Sipas gjykatës, viktimë e veprës penale nuk ishte nominalisht prokurori ose Prokuroria e Posaçme, ndërsa hetimi i veprave penale të kryera në kuadër të grupit të strukturuar kriminal përfshihej në kompetencën lëndore të kësaj prokurorie.

9. Në datën 27.04.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 29.04.2026.

II

Pretendimet e kërkuesit

10. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

9.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj,* pasi gjyqtari i seancës paraprake nuk ka verifikuar kompetencën lëndore të gjykatës, ndonëse rregullat për kompetencën i referohen në çdo rast gjykatës dhe procedimi i zhvilluar në shkelje të kompetencës lëndore konsiderohet i pavlefshëm. Për shkak të mangësive të hetimeve dhe mënyrës së arsyetimit të gjykatës nuk është analizuar ekzistenca e elementeve të bashkëpunimit ndërmjet të pandehurve, në funksion të akuzës për kryerjen e veprave penale në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, nga e cila varet edhe kompetenca lëndore e gjykatës për gjykimin e çështjes.

9.2. *Së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të barazisë së armëve*, pasi gjyqtari i seancës paraprake ka vendosur kalimin e çështjes në gjyq pa u bazuar në një shqyrtim ose në një listim të provave që vërtetojnë, në mënyrë të mjaftueshme, kryerjen nga kërkuesi të veprave penale për të cilat akuzohet. Kompetencat që ligjvënësi i ka

njohur gjyqtarit të seancës paraprake, ndër të tjera ato që lidhen me nenin 328 të KPP-së, synojnë garantimin e procesit të rregullt dhe shmangien e dërgimit në gjyq të një akuze të pambështetur. Kalimi i çështjes për gjykim e ka vendosur kërkuesin në pozitë të pafavorshme në raport me prokurorinë, pasi ai detyrohet që në gjykimin e themelit të provojë se ajo çfarë është reflektuar në vendimin e kundërshtuar për ekzistencën e veprave penale dhe formën e fajit nuk janë të vërteta. Kërkuesi duhet të provojë pafajësinë e tij për fakte që nuk ekzistojnë ose nuk parashikohen në ligj si vepër penale.

9.3. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykata nuk ka arsyetuar për ekzistencën e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet dy të pandehurve të tjerë dhe kërkuesit, si element i nevojshëm për ekzistencën e grupit të strukturuar kriminal. Në vendim mungon arsyetimi për "dijeninë" e personave të tretë për natyrën e materialeve të transmetuara, element ky shumë i rëndësishëm për vlerësimin e faktit historik në raport me faktin tipik dhe, për rrjedhojë, me kualifikimin juridik të veprës penale. Gjykata nuk ka analizuar nëse hyrja dhe vëzhgimi herë pas here i *e-mail*-eve, siç parashtrohej nga prokuroria, përmbushin elementet e anës objektive të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 293/a i KP-së dhe nëse, për rrjedhojë, kishte vend për zbatimin e nenit 328/1, shkronja "a", të KPP-së.

9.4 *Prezumimit të pafajësisë dhe të sigurisë juridike,* pasi Prokuroria e Posaçme ka synuar marrjen e kërkuesit si të pandehur dhe deklarimin e tij fajtor me çdo kusht. Ajo nuk ka prova për të mbështetur akuzën dhe regjistrimi i veprave penale të parashikuara nga nenet 333/a dhe 334 të KP-së ka shërbyer vetëm për të përligjur kompetencën lëndore të Prokurorisë së Posaçme. Po kështu, kërkesa për dërgimin në gjyq është mbështetur në faktin e përgjimit të të dhënave kompjuterike, fakt i cili nuk ekziston. Zbulimi i të dhënave të marra nga aktet hetimore nuk parashikohet nga ligji si vepër penale deri në momentin e paralajmërimit nga prokurori. Edhe pse prokuroria nuk kërkoi pushimin e çështjes, kjo duhej të vendosej nga gjyqtari i seancës paraprake, pasi nuk kishte nevojë për hetime të mëtejshme për të konkluduar se fakti për të cilin kërkuesi akuzohej nuk ekzistonte ose nuk parashikohej nga ligji si vepër penale.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesit

11. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, ndaj mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes, Kolegji mund të verifikojë një ose më shumë prej këtyre kritereve, pa qenë i detyruar të ndjekë një radhë të paracaktuar të analizës. Mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, me pasojë moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kritereve të tjera. Mbi këtë bazë, në vijim, Kolegji do të ndalet në verifikimin e kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*.

13. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, individi mund t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Detyrimin për përmbushjen e këtij kriteri Gjykata e ka vlerësuar si në rastet e vendimeve përfundimtare, që kanë përmbyllur në themel procesin gjyqësor, ashtu edhe në rastin e vendimeve të ndërmjetme, karakteri i të cilave është konsideruar përfundimtar për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, që do të thotë se, si rregull, ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor, pasi individi ka shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Ky kriter përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili, përpara se t'i drejtohet Gjykatës, duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Qëllimi i kësaj dispozite kushtetuese është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të

paraqiten në Gjykatë (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Megjithatë, Kolegji vëren se, në mënyrë përjashtimore, në juridiksionin kushtetues janë përfshirë edhe vendimet gjyqësore të ndërmjetme, kur plotësohen këto kushte: (i) shkelja e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm të kundërshtuar, pra provohet se kërkuesi është viktimë e shkeljes të së drejtës kushtetuese; (ii) vendimi është bërë objekt i ankimit të veçantë, kur ai parashikohet nga ligji, dhe ankimi është shqyrtuar nga gjykatat më të larta, të cilat të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet e cenuar; (iii) vendimi ka një shkallë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Të tilla janë edhe vendimet për caktimin ose zëvendësimin e masave të sigurimit personal (*shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 13.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*), ose ato për sekuestrimin e pasurive gjatë procedimit penal (*shih vendimet nr. 79, datë 12.11.2024; nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Përfshirja e këtyre vendimeve në kontrollin kushtetues është pranuar për shkak të pasojave që ato sjellin në të drejtat themelore të individit. Kjo lidhet me faktin se këto vendime kanë autonomi në raport me procesin gjyqësor të themelit, ku përcaktohet (pa)fajësia e personit, dhe se cenimi i pretenduar i të drejtave substanciale buron drejtpërdrejt prej tyre.

16. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi kundërshton vendimin e gjyqtarit të seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjyq. Sipas nenit 332/gj, pika 1, të KPP-së, kundër një vendimi të tillë nuk lejohet ankim. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk ka pasur në dispozicion një mjet të posaçëm ankimi për kundërshtimin e tij. Megjithatë, kjo rrethanë nuk është e mjaftueshme për të konsideruar si të shteruar mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave të pretenduara si të cenuara dhe as i jep atij vendimi karakter përfundimtar për qëllimet e kontrollit kushtetues. Për këtë qëllim, bazuar në standardet e mësipërme, duhet të vlerësohet natyra dhe efektet e vendimit të kundërshtuar, si dhe mundësia e shqyrtimit dhe e riparimit të cenimeve të pretenduara gjatë vijimit të procesit gjyqësor.

17. Në këtë drejtim, Kolegji vëren se vendimi i kundërshtuar për dërgimin në gjyq të çështjes penale edhe në ngarkim të kërkuesit i hap rrugë vijimit të procesit penal ndaj tij, pa përcaktuar në mënyrë përfundimtare (pa)fajësinë e kërkuesit për veprat penale për të cilat akuzohet. Për nga natyra dhe efektet e tij, ky vendim nuk sjell pasoja të drejtpërdrejta, të menjëhershme dhe të pariparueshme në të drejtat themelore të tij, të cilat nuk mund të riparohen gjatë vijimit të procesit penal. Në këtë kuptim, pretendimet e kërkuesit për cenimin

e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të së drejtës për t`u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të barazisë së armëve, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe parimeve të prezumimit të pafajësisë dhe të sigurisë juridike lidhen, në thelb, me kompetencën lëndore të gjykatës, ekzistencën dhe cilësimin juridik të akuzës, mjaftueshmërinë e provave dhe vlerësimin e tyre, pra me çështje që mund të parashtrohen dhe shqyrtohen nga gjykatat e zakonshme gjatë gjykimit të themelit. Në këtë proces kërkuesi mund të ushtrojë të drejtat e tij procedurale, personalisht ose nëpërmjet mbrojtësit, të parashtrojë pretendimet e tij edhe për kompetencën lëndore të gjykatës dhe ekzistencën ose cilësimin juridik të akuzës, të paraqesë provat që i konsideron të nevojshme në mbështetje të pretendimeve të tij, ose të kundërshtojë provat dhe pretendimet e prokurorisë. Po kështu, ai mund të ushtrojë mjetet e ankimit ndaj vendimit përfundimtar në gjykatat më të larta, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese. Për rrjedhojë, vendimi i kundërshtuar nuk ka atë shkallë autonomie nga procesi i themelit që t'i jepte atij karakter përfundimtar për qëllimet e kontrollit kushtetues, pasi çështjet e ngritura nga kërkuesi mund të shqyrtohen dhe, nëse është rasti, të riparohen gjatë vijimit të procesit penal dhe nëpërmjet mjeteve të ankimit ndaj vendimit përfundimtar.

18. Për sa më sipër, në kushtet kur vendimi objekt kundërshtimi nuk konsiderohet përfundimtar për qëllime të gjykimit kushtetues, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Kolegji vlerëson se nuk plotësohet kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion, për rrjedhojë, ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuesi nuk mund të merret në shqyrtim.

19. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja "d", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.